



RAPORT MONITORIMI PËR KOMUNËN E PODUJEVËS



Dhjetor 2020

Përmbajtja

Hyrje	4
Transparenca në Kuvendin Komunal.....	5
Konsultimi i projektbuxhetit të Komunës për vitin 2021	6
Çështjet e diskutuara në Kuvend.....	7
Pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit.....	7
Realizimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës.....	9
Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2019.....	10
Realizimi i Planifikimit të Prokurimit të vitit 2019	10
Aktivitetet e prokuruar.....	10
Kontratat e Vleres minimale.....	12
Transparenca në Prokurim	13
Planifikimi i aktiviteteve të prokurimit për vitin 2020.....	13
Realizimi i Planifikimit të aktiviteteve të prokurimit Janar-Tetor 2020.....	14
Transparenca në Prokurim (Janar-Tetor 2020)	15
Të gjeturat	16
Rekomandimet	17

“Ky publikim/raport monitorimi realizohet nga organizata SDK në kuadër të projektit *Qytetari aktive për transparencë dhe llogaridhënie në qeverisjen lokale*, që është duke u realizuar në kuadër të projektit **“GrassRoots Action Support”** që implementohet nga IKS, Lens dhe FES, financohet nga Bashkimi Evropian dhe menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë”

“Ky botim është prodhuar me përkrahjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e <emri i organizatës suaj> dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian ose IKS-së, Lens, apo FES”

Dhjetor, 2020

Hyrje

Raporti Monitorimit përmbledhë të gjetura nga aktiviteti monitorues i qeverisjes në Komunën e Podujevës për periudhën Janar - Tetor 2020. Në kuadër të këtij raporti janë përmbledhë të gjeturat nga monitorimi i Kuvendit Komunal, por duke pasur në fokus kryesor edhe prokurimin publikë. Një pjesë e të dhënave të paraqitura të prokurimit publikë janë edhe të periudhës gjatë tërë vitit 2019.

Ky raport mëton të masë dhe monitoroj punën e pushtetit lokal në Podujevë, duke përfshirë, elementet si transparenca e kuvendit dhe ekzekutivit, qasjen institucionale në raport me qytetarët e komunës së Podujevës, menaxhimin e seancave të kuvendit, publikimin e njoftimeve në ueb-in e komunës, punën dhe cilësinë e asamblesitëve, duke tentuar që të kemi një pasqyrë më të qartë të përmbushjes së indikatorëve që garantojnë një qeverisje të mirë lokale.

Pjesëmarrja dhe përfshirja e qytetarit në vendimmarrjen e komunës, është parakusht për funksionimin e ciklit, qeveri lokale-transparencë-përfshirje qytetare-demokraci lokale. Në këtë drejtim ky raport, është pasyqrë e përmbledhur e monitorimit duke tentuar të masë përmbushjen e elementeve të qeverisjes efektive nga ana e institucionit të komunës.

Spektori i prokurimit dhe menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit, në kuptimin e realizimit të tyre dhe transparenca në prokurim, janë të paraqitura në këtë raport. Duke qenë se puna dhe menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit ka ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin e kontratave qofshin ato furnizim, shërbim apo punë, të gjitha janë monitoruar në kuptimin e respektimit të procedurave dhe transparencës.

Puna dhe përpjekja e qeverisjes lokale, në përmbushjen e transparencës, përfshirjes qytetare, llogaridhënies, respektimi i kornizës ligjore, menaxhimi me financat publike dhe prokurimi në komunë, do të jenë fushat e vazhdueshme të monitoruara nga SDK.

Transparenca në Kuvendin Komunal

Vetqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënies, përgjegjshmërisë, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke i kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe kërkesave të qytetarëve të saj. Informimi, komunikimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitetet e qeverisjes lokale janë me rëndësi jetike për të vendosur një bashkëpunim dhe komunikim të rregullt në mes të komunës dhe qytetarëve.

Kuvendi Komunal në Podujevë ka aprovuar disa dokumente që sigurojnë transparencë gjatë mbarëvajtjes së punëve të qeverisjes lokale. Por, implementimi i tyre në praktikë mbetet sfidë, për faktin se nuk arrihet të implementohen në tërësi. Është Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Podujevës për periudhën 2019-2023, gjegjësisht pika 3 e objektivës së parë(I), në të cilën thuhet se *“Mbledhjet e kuvendit do të përcjellën drejtpërdrejtë-online përmes faqes zyrtare të Komunës dhe teleprezencës për monitorim nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, dhe kanalit të You tube”*. Komuna e Podujevës që nga aprovimi i këtij Plani nuk ka ndërmarrë asnjë hap në drejtim të transmetimit online të seancave të kuvendit, përmes kanalit në YouTube.


Në këtë kontekst komuna e Podujevës me qëllim të krijimit të hapësirës edhe më të gjerë informuese për qytetarët, do duhej të gjej mundësinë e hapjes së kanalit zyrtar në “You tube” dhe të shfrytëzoj vegëzen ekzistuese në ueb faqen e komunës, për transmetimin online të seancave të Kuvendit, si dhe të publikimit të të gjitha materialeve audio-vizuele në kuadër të aktiviteteve të Komunës.

Kjo do të ndikonte në rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe njëkohësisht në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve.

Konsultimi i projekt-buxhetit të Komunës për vitin 2021

Planifikimi i buxhetit Komunal është proces që fillon nga Planifikimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore që aprovohet nga Kuvendi komunal deri më 30 qershor dhe përfundon me planifikimin e draftit final të projekt-buxhetit për vitin vijues i cili aprovohet nga Kuvendi deri më 30 shtator. Në tërë këtë proces ligjet në fuqi si Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Statuti i Komunës dhe Rregullorja Komunale për Transparencë, përcaktojnë procedurat për autoritetet komunale që duhet të ndjekin për konsultim të publikut para miratimit të buxhetit.

Fig. 1. Procesi i planifikimit buxhetore në nivel komunal, duke pasur në fokus edhe konsultimin qytetarë.



Sipas procedurave, pas miratimit të KAB-it, autoritetet Komunale gjegjësisht ekzekutivi komunës, fillon hartimin e draft-buxhetit për vitin vijues duke pasur parasyshë konsultimet publike me qytetarë. Nga data 1 shtator ekzekutivi dërgon draft-buxhetin tek Kuvendi Komunal i cili vendosë të e kaloj për konsultim me publikun për të paktën 14 ditë. Pas këtij procesi draft-buxheti vjen përsëri në kuvend dhe aprovohet. Kjo praktikë nuk është ndjekur nga Komuna e Podujevës, përveç disa takimeve që ka zhvilluar në muajin qershor për Kornizën Afatmesme Buxhetore-KAB. Ndërsa ekzekutivi nuk ka zhvilluar asnjë takim për hartimin e draft-buxhetit, rrjedhimisht i bije që komuna e Podujevës nuk ka hartuar një draft-buxhet duke u konsultuar me qytetarë. Në anën tjetër as Kuvendi komunal nuk ka marrë vendim për të vë në diskutim publik draft-buxhetin e propozuar nga ekzekutivi.

Meqenëse i tërë procesi i planifikimit buxhetor ka qenë i sfiduar me masat në fuqi kundër pandemisë, të cilat kanë pamundësuar tubimet publike me qytetarë, Komuna e Podujevës është dashur të gjejë forma dhe alternativa tjera të konsultimit qytetare. Një prej tyre do të ishte shfrytëzimi i platformave online, që do të i mundësonte qytetarëve pjesëmarrjen e tyre në hartimin e projekt buxhetit për vitin e ardhshëm. Gjatë tërë këtij procesi Komuna e Podujevës nuk ka aplikuar asnjë prej platëformave online, për të konsultuar qytetarët e saj.

Çështjet e diskutuara në Kuvend

Menaxhimi financiar dhe buxheti komunal - Në lidhje me këtë fushë janë diskutuar e miratuar si: Korniza Afatmesme Buxhetore 2021/2023; Raporti financiar për tremujorin e parë të vitit 2020 si dhe Projekt buxheti komunal për vitin 2021

Miratimi dhe propozim rregullore Komunale – Në lidhje me rregulloret gjatë kësaj periudhe është miratuar Rregullorja për orarin e punës për bizneset që operojnë në teritorin e Komunës së Podujevës. Është diskutuar edhe Rregullorja Organizimi, Funksionimi dhe Bashkëpunimi i Komunës së Podujevës me Fshatrat, Vendbanimet dhe lagjet Urbane; propozim rregullore për ndryshimin dhe plotësimi e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Podujevës.

Llogaridhënia Komunale – Informatë e drejtorisë së arsimit për përfundimin e vitit mësimor 2019/2020; informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit; informatë nga drejoria e shëndetësisë dhe mirëqenies Sociale, rreth gjendjes së krijuar nga Corona virusi COVID-19 në teritorin e Komunës së Podujevës.


Dokumente strategjike - Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik lokal 2020-2022 në Komunën e Podujevës; harta Zonale e komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028; Plani i punës së këshillit Komunal për Siguri në bashkësi-KKSB për vitin 2020

Pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit

Një ndër mekanizmat e për ushtrimin e kontrollit të lëgjislativit ndaj ekzekutivit është edhe duke parashtruar pyetje për ekzekutivin.

Në bazë të monitorimit të vazhdueshëm të seancave të kuvendit, SDK ka evidentuar pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit drejtuar ekzekutivit dhe janë numruar në total pyetje sipas subjekteve politike.


Fig.2. Numri i pyetjeve të shtruar nga subjektet politike në Kuvend



Në bazëtë pyetjeve të parashtruara, është bërë edhe ndarja në bazë të subjekteve politike, si dhe në bazë të çështjeve/fushave të prekura nga pyetjet e parashtruara.

Grafikoni në vijim tregon numrin e pyetjeve të parashtruara nga anëtarët e Kuvendit, në bazë të subjekteve politike


Fig 3. Pyetjet në bazë të çështjeve/fushave



Realizimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës

Plani i Punës së Kuvendit është një dokument i rëndësishëm i cili shërben si udhrrëfyes gjatë mbarvajtjes së seancave, në mënyrë që legjislativi të ketë rol më të theksuar në mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit.

Fig. 4. Realizimi i Planit të Punës së Kuvendit



Për gjatë periudhës Janar-Shtator, shohim që në seancat e Kuvendit janë shqyrtuar edhe më shumë pika se sa që janë planifikuar. Por ka edhe pika të cilat kanë qenë të planifikuara por nuk janë shqyrtuar që janë 16 prej tyre. Ndërsa janë vetëm 9 pika të cilat janë shqyrtuar sipas planifikimit me Plan të Punës së Kuvendit

Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2019

SDK, ka bërë një vlerësim të performancës së prokurimit të aktiviteteve gjatë vitit 2019, duke u fokusuar në realizimin e planifikimit të prokurimit dhe transparencën e aktiviteteve të prokuruar.

Realizimi i Planifikimit të Prokurimit të vitit 2019

Fig.5. Realizimi i Planifikimit të prokurimit




Nga të dhënat e paraqitura në fig.1 shihet se planifikimi i prokurimit për vitin 2019 ka ngecje në realizim të plotë të tij. Nga gjithësej 111 aktivitete të planifikuara për prokurim, janë vetëm 62 aktivitete të cilat janë prokuruar. Ndërsa të pa realizuara kanë mbetur 49 aktivitete. (Nga kjo është parë se vetëm 55.86% është realizuar Planifikimi i prokurimit për vitin 2019, përderi sa ka mbetur pa u realizuar 44.14%)

Aktivitetet e prokuruar

Nëse i referohemi në tërësi aktiviteteve të prokuruar gjatë vitit 2019, shohim që janë një numër shumë më i madhë se sa kanë qenë të planifikuara.

Fig.6. Aktivitetet e prokuruar (Të planifikuara dhe pa planifikuara)




Nga fig.6 shohim se janë gjithsej 179 aktivitete të prokuruar. Krahasuar me Planifikimin fillestar të prokurimit, shohim se janë 117 aktivitete të prokuruar të cilat nuk kanë qenë fare të përfshira me Planifikim fillestar. Pra 65.36% e aktiviteteve të prokuruar gjatë vitit 2019 janë jasht Planifikimit fillestar të prokurimit.

Kontratat e Vleres minimale

Në kuadër të numrit të përgjithshëm të aktiiteteve të prokuruar shohim se janë 52 kontrata të lidhura të vlerës minimale, të cilat nuk kanë qenë fare të përfshira në Planifikimin fillestar të prokurimit. Kjo tregon për një jo seriozitet të planifikimit të prokurimit dhe mos përfillje të zbatimit të këtij planifikimi.


Fig.7. Kontratat e vleres minimale



Transparenca në Prokurim

Sa i përket transparencës së aktiviteteve të prokurimit për vitin 2019, fokusi ka qenë tek publikimi i kontratave në uebfaqen e komunës.

Fig.8. Publikimi kontratave në ueb faqe të Komunës




Siç shihet janë 179 kontrata të lidhura, nga to 105 prej tyre nuk janë fare të publikuara, ndërsa 69 prej tyre janë të publikuara, por duke mos përfshirë pjesën kryesore të Kontratës që është Paramasa dhe Parallogaria. Ndërsa janë vetëm 5 kontrata të publikuara që përfshihet edhe paramasa dhe parallogaria.

Planifikimi i aktiviteteve të prokurimit për vitin 2020


Sipas Planifikimit të aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2020, janë parapara 145 aktivitete. Nëse i shohim për nga lloji i kontratës potenciale që mund të lidhet, 46 prej tyre janë të parapara për Furnizim, 34 janë paraparë për shërbime dhe 45 janë të planifikuara për punë.

Fig.9. Aktivitetet e planifikuara sipas llojit të kontratës



Realizimi i Planifikimit të aktiviteteve të prokurimit Janar-Tetor 2020

Fig.10. Realizimi i Planifikimit të Prokurimit për gjatë periudhës Janar-Tetor 2020



Siç mund të shihet nga fig.10, për gjatë kësaj periudhe kohore janë prokuruar vetem 78 aktivitete nga planifikimi i aktiviteteve. Nëse llogarisim në përqindje i bje të jet 53.79% është realizuar Planifikimi i aktiviteteve. Nëse këtë përqindje të realizimit e krahasojmë me periudhën kohor (Janar-Tetor), nuk mund të konsiderojmë që janë zhvilluar punimet me efikasitet të duhur.


Fig.11. Realizimi aktiviteteve sipas llojit të kontratave



Transparenca në Prokurim (Janar-Tetor 2020)

Kryesisht fokusi ka qenë në publikimin kontratave të lidhura, duke pasur parasysh pjesën e paramasës dhe paralogarisë së kontratave të lidhura.

Fig.12. Publikimi kontratave në ueb faqe të Komunës (Janar-Tetor 2020)



Siç mund të shihet nga figura janë gjithsej 89 kontrata të lidhura gjatë periudhes kohore Janar-Tetor 2020. Prej tyre janë vetem 9 kontrata të cilat nuk janë të publikuara fare. Ndërsa të publikuara janë janë 79 kontrata, por janë vetëm 28 prej tyre të cilat përmbajnë edhe pjesen kryesore siç është Paramasa dhe Parallogaria, kurse 51 prej tyre nuk përmbajnë fare Paramasën dhe Parallogarinë .

Të gjeturat

- Edhe për kundër Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë, i cili obligon transmetimin e drejtpërdrejtë online të seancave. Komuna e Podujevës nuk ka ndërmarr asnjë hap në drejtim të transmetimit online të seancave të kuvendit, përmes kanalit në YouTube.
- Komuna e Podujevës, gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2021, nuk ka përfillur në tërësi procedurat e konsultimit qytetarë. Nuk është zhvilluar asnjë takim konsultues me qytetarë, as edhe në formë elektronike (online).
- Komuna e Podujevës është mjaft e vonuar në hartimin e legjislacionit që rregullon bashkëpunimin e Komunës së Podujevës me qytetarë të vendbanimeve të saj. Si rrjedhojë e saj Komuna e Podujevës nuk ka këshilla të fshatrave dhe lagjeve urbane të zgjedhur, por ka disa administrator të emeruar krejtësisht në baza politike dhe janë jo funksional.
- Në Komunën e Podujevës 44.14% e Planifikimit të Prokurimit të vitit 2019 nuk është realizuar fare. Ndërsa 65.36% e aktiviteteve të prokuruar janë jashtë planifikimit fillestar.
- Në planifikimin e prokurimit të vitit 2019 nuk figuron asnjë kontratë e vlerës minimale. Ndërsa nga prokurimi i aktiviteteve shohim se janë rreth 52 kontrata të lidhura të vlerës minimale.
- Gjatë vitit 2019 janë të lidhura gjithsej 179 kontrata përmes prokurimit publik, prej 105 nuk janë fare të publikuara në ueb faqen e komunës. Ndërsa janë të publikuara vetem 74 prej tyre, por vetem 5 kontrata përmbajnë edhe pjesen kryesore të kontratës që është Paramasa dhe Parallogaria.
- Gjatë periudhes Janar-Tetor të vitit 2020 janë gjithsej 89 kontrata të lidhura përmes prokurimit publik. Prej tyre janë vetem 9 kontrata të cilat nuk janë të publikuara fare në ueb faqen e komunës. Ndërsa të publikuara janë janë 79 kontrata, por janë vetëm 28 prej tyre të cilat përmbajnë edhe pjesen kryesore siç është Paramasa dhe Parallogaria, kurse 51 prej tyre nuk përmbajnë fare Paramasën dhe Parallogarinë.
- Realizimi i Planifikimit të prokurimit për periudhën Janar-Tetor 2020 është realizuar vetem 53.79%. Nëse këtë përqindje të realizimit e krahasojmë me periudhën kohor (Janar-Tetor), nuk mund të konsiderojmë që janë zhvilluar punimet me efikasitet të duhur.
- Komuna e Podujevës nuk ofron qasje në dokumentet publike. OJQ SDK me datë 13 nëntor 2020 ka bërë një kërkesë për qasje në dokumente publike, për të parë se sa është numri i kontratave të lidhura të vlerës minimale për periudhën Janar-Tetor 2020, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Rekomandimet

- SDK, duke e parë trendin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, rekomandon Komunën e Podujevës, që t'i kushtoj rëndësi dhe seriozitet Planifikimit të mirëfilltë të prokurimit. Procesi i prokurimit të udhëhiqet sipas afateve kohore të parapara si dhe sipas çdo planifikimi, në mënyrë që të minimizohen aktivitetet jasht planifikimit fillestar.
- Çdo kontratë e lidhur me operatorët ekonomik nga komuna, rekomandojmë që të publikohet me gjitha dokumentet bashkëngjitëse (Paramasa dhe Paralogaria), në mënyrë që të nxitet mbikëqyrja qytetare gjatë implementimit të projekteve apo punëve në teren. Kjo do të ndikonte në rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe njëkohësisht në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve.
- Meqë Komuna e Podujevës, ende nuk ka të zgjedhur këshilla të fshatrave dhe lagjeve urbane, por ka disa administrator të emruar krejtësisht në baza politike dhe janë jo funksional. Rekomandojmë, që sa më parë të ndërmer hapat e duhur në aprovimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës së Podujevës me Fshatrat, Vendbanimet dhe lagjet Urbane. Në këtë mënyrë të i hapë rrug zgjedhjes së rregullt të këtij procesi.
- Meqenëse Komuna e Podujeves nuk ka përfillur procedurat e konsultimit publik gjatë Planifikimit të Buxhetit për vitin 2021, rekomandojmë Komunën që të respektohet në tërësi spektri ligjor i transparencës gjatë planifikimit të buxhetit. Pavarësisht situatave emergjente që mund të krijohen sic është pandemia COVID-19, rekomandojmë Komunën që të gjej forma dhe alternativa tjera përmes krijimit të platformave online për të konsultuar qytetarët
- Rekomandojmë Komunën e Podujevës për transparencë gjatë mbarëvajtjes së seancave të Kuvendit duke shfrytëzuar vegëzen ekzistuese në ueb faqen e komunës, për transmetimin online të seancave të Kuvendit, përmes hapjes së kanalit zyrtar në You Tube



“Ky botim është prodhuar me përkrahjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e <emri i organizatës suaj> dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian ose IKS-së, Lens, apo FES”